



## ZYRA E MBROJTJES NDËRKOMBËTARE

### SHTESA NR. 2 PËR BROSHURËN INFORMATIVE PËR APLIKUESIT

### PËR MBROJTJE NDËRKOMBËTARE (IPO1)

#### NJOFTIM INFORMATIV

**Emërimi nga ana e Ministrit të Drejtësisë dhe Barazisë i disa shteteve të caktuara si shtete të sigurta të origjinës sipas Ligjit për Mbrojtje Ndërkombëtare, 2015**

Sipas nenit 72 të Ligjit për Mbrojtje Ndërkombëtare, 2015 dhe Ligjit për Mbrojtje Ndërkombëtare të vitit 2015 (Vendet e Sigurta të Origjinës) Urdhëri 2018 (Instrumenti Statutor 121, 2018), Ministri i Drejtësisë dhe Barazisë ka emëruar vendet e mëposhtme si vende të sigurta të origjinës, **me efekt nga dita e hënë, 16 prill 2018.**

**Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Gjeorgjia, Kosova, Maqedonia (Ish Republika Jugosllave), Mali i Zi, Serbia dhe Afrika e Jugut.**

Nëse jeni aplikues për mbrojtje ndërkombëtare në këtë Shtet nga njëri prej këtyre vendeve, aplikacioni juaj do të shqyrtohet në mënyrë të plotë në bazë të meritave të tij në Zyrën e Mbrojtjes Ndërkombëtare (IPO). Megjithatë, situata e mëposhtme do të zbatohet për qëllimet e vlerësimit të tij:

- (i) Aplikacionit tuaj për mbrojtje ndërkombëtare mund t'i jepet prioritet për intervistë;
- (ii) Shteti juaj do të konsiderohet si një shtet i sigurt i origjinës në lidhje me aplikacionin tuaj, në rast se nuk paraqitni arsye serioze që shteti juaj të mos konsiderohet shtet i sigurt i origjinës në rrethanat tuaja të veçanta dhe në lidhje me të drejtën tuaj për mbrojtjen ndërkombëtare.
- (iii) Nëse rekomandimi i një Zyrtari për Mbrojtje Ndërkombëtare është se juve nuk duhet t'ju jepet as deklarata e refugjatit, dhe as deklarata e mbrojtjes shtesë, konkluzioni që jeni nga një shtet i sigurt i origjinës mund të përfshihet në seksionin 39 të Raportit të ekzaminimit të aplikacionit tuaj.
- (iv) Në raste kur merret një vendim i tillë, çdo ankesë e paraqitur nga ju në Tribunalin e Ankesave për Mbrojtje Ndërkombëtar (TAMN) duhet të bëhet përmes njoftimit me shkrim brenda 10 ditëve të punës nga data e dërgimit të njoftimit të rekomandimit nga Ministri.
- (v) Përveç se në rastet kur TAMN e konsideron se nuk është në interes të drejtësisë ta bëjë këtë, ai do të marrë vendim lidhur me ankesën pa mbajtur seancë dëgjimore.

**Zyra e Mbrojtjes Ndërkombëtare**

**20 Prill 2018s**